

Biodiversiteti, ndryshimet klimaterike dhe Synimet e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (MDGs)



BIODIVERSITETI DHE NDRYSHIMET KLIMATERIKE: LIDHJET ME VARFËRINË DHE URINË

Ndryshimet klimaterike po kërcënon biodiversitetin, duke rrezikuar realizimin e Synimeve të Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Mijëvjeçarit (MDGs). Mbrojtja e Biodiversitetit dhe mbrojtja e integritetit të ekosistemeve janë thelbësore në uljen e cënueshmërisë së njerëzve ndaj ndryshimit të klimës dhe ndaj realizimit të MDG-s.

MDG 1: ZHUKJA E VARFËRISË TË SKAJSHME DHE URISË

Synimi i 1rë i Zhvillimit të Mijëvjeçarit synon të zhdukë varfërinë dhe urinë deri në vitin 2015. Objektivat specifike brenda MDG1 përfshijnë pakësimin sa më shumë të raportit të jetesës së njerëzve (i) në më pak se një dollar në ditë dhe (ii) vuajtjes nga uria.

Roli i biodiversitetit në zhdukjen e varfërisë dhe urisë

Njerëzit me mjete jetese të bazuara mbi ekzistencën shpesh varen thellësisht dhe drejtpërdrejt nga biodiversiteti për sigurimin e mjeteve të tyre të jetesës. Për shembull, në zonat rurale në Zimbabve, produktet e egra sigurojnë 37 % të të ardhurave totale familjare, dhe në tokat e thata të Indisë, ku produktet e egra sigurojnë normalisht 14-23% të të ardhurave më të pamjaftueshme në zonat rurale, në kohët e thatësirës kjo rritet deri në 42-57%¹. Mënyrat nëpërmjet të cilave një familje e varfër siguron të ardhurat dhe plotëson nevojat e saj bazë plotësohen shpesh nëpërmjet aktiviteteve të jetesës që lidhen me mjedisin natyror. Për shembull, shfrytëzimi i burimeve të zakonshme të pronës (aseteve) të tilla si peshqit, kullotat ose pyjet mund të sigurojnë të ardhura, ushqim, barna, lëndë djegëse, thesë (tagji-ushqim të thatë) për bagëtitë dhe materiale ndërtimi. Të varfërit, si rrjedhim ndikohen ndjeshëm kur mjedisi degradohet, kur ka humbur biodiversiteti ose mundësia e njerëzve për të ndikuar mbi to është kufizuar². Burimet e Biodiversitetit gjithashtu po hyjnë gjithnjë e më shumë në vëmendje përmes programeve të mikro-kredive (kredive të vogla), shumica e të cilave bazohen në mënyra të ndryshme të jetesës që mbështeten në përdorimin mbështetës të kallamishteve, barërave dhe produkteve pyjore jo-për lëndë druri.

Biodiversiteti është gjithashtu kritik për mbrojtjen dhe rivlerësimin e sigurisë së ushqimeve³. Konservimi dhe ruajtja e tokës së shëndetshme, ujit të pastër, një shumëllojshmërie të burimeve gjenetike dhe proceseve ekologjike janë përbërësit thelbësorë të një sistemi bujqësor mbështetës dhe prodhues dhe zhdukjes së mëvonshme të urisë.

Shumëllojshmëria në biodiversitetin gjenetik është veçanërisht e rëndësishme në tokat e varfra, ku përshatjet gjenetike ndaj kushteve të tilla si mungesa e ujit dhe pjelloria e ulët e tokës janë kritike për ruajtjen e bujqësisë lokale të jetesës së kullotave.

Përtej burimeve bujqësore tokësore, përbërës të tjerë të biodiversitetit që duhet të mbrohen për të garantuar sigurimin e ushqimit përfshijnë peshkimin, që varet nga mbrojtja e ekosistemeve, të tilla si lagunat, rizoforet dhe gumët e koralit, që iu sigurojnë peshqve mjedisin banues dhe jetesën⁴.



Foto nga Parc Cruz

1 IUCN/DFID/EC. Biodiversiteti Përmbledhje 1: Lidhjet ndërmjet biodiversitetit dhe varfërisë.

Në linjë direkte në internet në adresën <http://www.undp.org/biodiversity/biodiversitycd/BioBrief1-poverty.pdf>

2 Roe, D., 2004. Qëllimet e Zhvillimit të Mijëvjeçarit dhe Mbrojtja – Menaxhimi i Shëndetit të Natyrës dhe Shëndetit të Shoqërisë. ILED.

3 Scherr, S. J. Biodiversiteti dhe Siguria e Ushqimit. Direkt në internet në adresën <http://www.undp.org/biodiversity/biodiversitycd/biodev3.htm>

4 UNDP. Biodiversiteti dhe Qëllimet e Zhvillimit të Mijëvjeçarit. Direkt në Internet në adresën <http://www.undp.org/biodiversity/mdgandbiodiversity.html>

Ndikimet e ndryshme të klimës në zhdukjen e varfërisë dhe urisë

Ndryshimi i klimës është projektuar për të kufizuar pronat (asetet) e jetesës së njerëzve të varfër, të tilla si mundësia për të patur ujë, shtëpi dhe infrastrukturë. Ndryshimi i klimës pritet të ketë gjithashtu një ndikim negativ mbi mekanizmat tradicionalë të daljes mbanë në gjendje vështirësish duke rritur si rrjedhim cënuesmërinë e njerëzve të varfër në botë ndaj shqetësimeve të tilla si thatësitrat, përmytjet dhe sëmundjet. Ndikimi i ndryshimit klimaterik mbi burimet natyrore dhe prodhimtarinë e punës janë të mundshme për të pakësuar rritjen ekonomike, zhdukjen e varfërisë përmes mundësive të kufizuara të të ardhurave.

Ndryshimi klimaterik është projektuar gjithashtu për të ndryshuar sigurimin e ushqimit në rajon. Ndryshimet në sistemin e rreshjeve dhe fenomenet më të skajshme të motit janë të prishme për pakësimin e të korrave në shumë zona.



Foto e US Fish and Wildlife Service

Ndryshimet në mjedisin ku jetojnë (habitat) total janë duke ndikuar pothuajse negativisht mbi proteinat e kapshme nga gjuetia, veçanërisht në rajonin Arktik.

Biodiversiteti dhe faktorët e ndryshimit klimaterik për realizimin e MDG 1

Mbrojtja e biodiversitetit, që përfshin restaurimin dhe rehabilitimin, mund të jetë një strategji kyç e përshtatjes për të ndihmuar njerëzit në nevojë në përbalimin e ndryshimit të klimës. Për shembull⁷, rizoforët sigurojnë mbrojtjen bregdetare ndaj ngritjeve të nivelit të deteve dhe ngritjeve të dallgëve nga stuhitë. Që në vitin 1994, Grupi Kombëtar i Vietnamit i Kryqit të Kuq kishte punuar me komunitetet lokale për të rehabilituar rizoforët, afërsisht 12,000 hektarë të rizoforëve ishin mbjellë dhe ndonëse mbjellja dhe mbrojtja e rizoforëve kushtuan afërsisht 1.1 milion dollarë amerikanë, ajo kurseu 7.3 milion dollarë në vit për mbrojtjen e argjinaturave.

Gjatë shkatërrimit të tajfunëve Wukong në 2000, zonat e projektit mbetën të padëmtuara, ndërsa provincat fqinjë vuajtën humbje të mëdha në njerëz, prona dhe

mjete të jetesës. Kryqi i Kuq Vietnamez llogariti rreth 7,750 familje që kishin përfituar nga rehabilitimi i rizoforëve dhe që ishin në gjendje të fitonin gjithashtu të ardhura shtesë nga shitja e gaforreve, karkalecëve dhe molusqeve (butakëve), ndërsa shtonin sasinë e proteinave të marra në dietën e tyre.

Mbrojtja e shumëllojshmërisë tradicionale të të korrave është një mjet i rëndësishëm në përshtatjen ndaj ndryshimit të klimës, duke siguruar që janë të disponueshme varietete të përshtatshme për kushte të ndryshme. Komunitetet fisnore në Traktin Jeypore të Orisë (Indi), me mbështetjen e Fondacionit Kërkimor të M.S. Swaminathan, filluan punën për konservimin e shumëllojshmërive gjenetike të të korrave bujqësore për të siguruar furnizimin me ushqime të mjaftueshme⁸ duke vënë në punë farat (të mbjellat) e komunitetit dhe pargjet e drithrave. Projekti inkurajonte gjithashtu kultivimin e bimëve mjekësore të shfrytëzuara jashtë mase në kopshtet komunitare, për të kufizuar vartësinë dhe dëmin në pyjet lokale. Puna për të rritur tregjet për varietetet tradicionale të orizit dhe bimëve mjekësore gjithashtu solli përfitime në të ardhura.

Përveç se biodiversiteti luan një rol kryesor në shumë



Fëmijë duke mbajtur peshkun.
Foto e Domi/UNEP/Alpha Presse

strategji të përshtatjes së ndryshimit të klimës, ndryshimi i klimës po kërcënon biodiversitetin që është thelbësor për jetesën veçanërisht ndërmjet popullatave të zonave rurale dhe njerëzve indigjenë (vendës). Për shembull, speciet e huaja pushtuese pothuajse po ndryshojnë përbërjen e specieve në tokat e kullotave nga Savana Afrikane në kullotat e

drerëve veiorë. Këto ndryshime në përbërjen e specieve po ndikojnë negativisht në shëndetin e bagëtive dhe po kërcënojnë mjetet e jetesës me bazë gjënë e gjallë.

Duke qenë se burimet mbi biodiversitetin sa vjen e po bëhen më të rëndësishme në realizimin e MDG1 nën ndryshimin e kushteve klimaterike, këto burime të njëjta po përballen gjithnjë e më tepër me kërcënime nga ndryshimi klimaterik. Udhëheqja e harmonizuar e biodiversitetit dhe ndryshimit klimaterik brenda strategjisë së reduktimit të varfërisë dhe planifikimit të sigurimit të ushqimit është si rrjedhim kritik nëse është plotësuar MDG1.

⁵ Pisupati, B. dhe E. Warner, 2003. Biodiversiteti dhe Qëllimet e Zhvillimit të Mijëvjeçarit. IUCN/UNDP.

⁶ Veprimet e Rrjetit Australian për Ndryshimet Klimaterike (CANA). Ndikimi social i Ndryshimit Klimaterik: ndikimet në Qëllimet e Zhvillimit të Mijëvjeçarit. Direkt në internet në adresën <http://www.cana.net.au/socialimpacts/global/millen-nium-development-goals.html>

^{7, 8} Dharmaji, B., Raban, A., Pisupati, B., dhe H. Baulch, 2005. Një imazh i udhëzimeve për biodiversitetin e rrymës qendrore dhe zhvillimin në Programet Kombëtare të Përshtatjes (NAPAs). IUCN.

Biodiversiteti, ndryshimet klimaterike dhe Synimet e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (MDGs)



BIODIVERSITETI DHE NDRYSHIMET KLIMATERIKE: LIDHJET ME EDUKIMIN DHE BARAZINË GJINORE

Ndryshimi klimaterik po kërcënon biodiversitetin, duke rrezikuar realizimin e Synimeve të Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Mijëvjeçarit (MDGs). Mbrojtja e Biodiversitetit dhe mbrojtja e integritetit të ekosistemeve janë thelbësore në uljen e cënueshmërisë së njerëzve ndaj ndryshimit të klimës dhe ndaj realizimit të MDG-s.

MDG 2: ARRITJA E ARSIMIMIT FILLOR NË MBARË BOTËN

Synimi i dytë i Zhvillimit të Mijëvjeçarit është të sigurojë që deri në vitin 2015, të gjithë djemtë dhe vajzat të jenë të aftë të ndjekin një kurs të plotë të arsimit fillor.

MDG 3: NXITJA E BARAZISË GJINORE DHE FUQIZIMI I GRAVE

Synimi i tretë i Zhvillimit të Mijëvjeçarit synon të përjashtojë pabarazinë gjinore dhe shkollën e mesme deri në vitin 2015.

Roli i biodiversitetit në sigurimin e arsimit fillor në mbarë botën dhe barazisë gjinore

Biodiversiteti ndikon mundësinë për t'u arsimuar dhe barazinë gjinore duke rritur kohën e shpenzuar nga gratë dhe fëmijët për kryerjen e disa detyrave në mirëmbajtjen e shtëpisë dhe kështu kohën e disponueshme për arsimim dhe aktivitete të tjera. Degradimi i ekosistemeve dhe humbja shoqëruese e biodiversitetit, shpesh rezultojnë që në shumicën e kohës është harxhuar për të grumbulluar burime të tilla si lëndë djegëse dhe ujë të pijshëm¹. Biodiversiteti gjithashtu duhet të luajë një rol kritik në sigurimin e ushqimit, i cili është i lidhur direkt me të dy kategoritë e arsimit dhe cilësisë së mësimdhënies². Veç kësaj, mbrojtja dhe përdorimi i pandërprerë i



Gra fermere përbëjnë rreth 60-80% të prodhuesve të ushqimit në vendet në zhvillim sipas FAO-s

burimeve të biodiversitetit ka qenë i lidhur ngushtë me prodhimin e shtuar të tokave bujqësore. Kjo është veçanërisht e rëndësishme midis grave fermere, të cilat llogariten që sigurojnë kohët e fundit 60-80% të gjithë prodhimin ushqimor në vendet e zhvilluara³. Sidoqoftë, këto gra shpesh mbeten pa u vënë re në vendim-marrje në mundësinë për të ndikuar mbi burimet e biodiversitetit kritike për mjetet e tyre të jetesës⁴.

1 Pisupati, B. and E. Warner, 2003. Biodiversiteti dhe Synimet e Zhvillimit të Mijëvjeçarit

2 UNESCO, 2000. Studim Tematik mbi Shëndetin dhe Ushqyerjen në Shkollë. Forum Edukues. IUCN/UNDP. Vlerësimi i "Arsim për të Gjithë" i vitit 2000.

3 FAO FOCUS: Mbrojtja e Grave dhe Ushqimit. Direkt në Internet në adresën <http://www.fao.org/FOCUS/E/Women/Sustin-e.htm>

4 FAO FOCUS: Mbrojtja e Grave dhe Ushqimit. Direkt në Internet në adresën <http://www.fao.org/FOCUS/E/Women/Sustin-e.htm>



Foto Tris Clements

Ndikimi i ndryshimit klimaterik në arritjen e MDG 2 dhe 3

Ndodhitë e skajshme të motit kërcënojnë infrastrukturën arsimore, duke e bërë atë të pamundur fizikisht për fëmijët që ndjekin shkollën. Të tilla ndodhi mund të çojnë gjithashtu në zhvendosje dhe shpërngulje (migracion), duke kufizuar mundësinë për t'u arsimuar. Nivelet e arsimit mund të bien për shkak të ndryshimeve të ndikuara nga klima në të ardhura dhe në kushtet shëndetësore. Keqësimi i kushteve shëndetësore mund të ndikojë afërsisht e një fëmije për të mësuar dhe për të ndjekur shkollën. Pasi të ardhurat, pronat dhe mundësitë për punësim janë ndikuar nga ndryshimi i klimës, shkollimi mund të bëhet më pak përballeshëm dhe i arritshëm⁵.

Pasi ndryshimi klimaterik mund të shkaktojë humbje domethënëse në biodiversitet⁶, barra e punëve për gratë dhe fëmijët do të rritet dhe do të shpenzojë më tepër kohë. Kjo do të kufizojë sasinë e kohës të disponueshme për arsimim dhe aktivitete të tjera që iu japin më tepër fuqi atyre.

Biodiversiteti dhe faktorët e ndryshimit klimaterik realizimin e MDG 2 dhe 3

Duke marrë në konsideratë që ndryshimi klimaterik kërcënon arsimimin dhe barazinë gjinore, mbrojtja



Fëmijët e shkollës në Laos. Foto e Claudio Ramirez

ndaj ndodhive të skajshme të motit përfaqëson një masë të rëndësishme për t'u ndërmarrë që të plotësohen MDG2 dhe 3. Biodiversiteti ka krijuar bazën e shumë strategjive për zbutjen e fatkeqësive natyrore. Guma koralore dhe rizoforët sigurojnë mbrojtje natyrore të bregdetit nga përmbytjet dhe dallgët e mëdha të stuhive. Mbrojtja e tyre si rrjedhim mund të jetë shumë e dobishme. Pasi kushtet klimaterike ndryshojnë, këto strategji bëhen edhe më të rëndësishme.



Fëmijët e shkollave nga Myanmar. Foto e Anna Fabro

Një projekt pilot në një fermë në Senegal siguron një shembull sesi zbutja dhe përshtatja e ndryshimit të klimës mund të kombinohet në një mënyrë që të rritë të ardhurat dhe t'u japë larmi mjeteve të jetesës, ndërsa të sigurojë gjithashtu përfitime për biodiversitetin, barazinë gjinore dhe izolimin e karbonit⁷. Ferma pilot në Niayes, Senegal, e ndihmuar të fillojë në vitet 1970, është zhvilluar me kalimin e kohës në adresimin e ndryshimeve të klimës të tilla si thatësitrat e njëpasnjëshme. Gardhe të dendur ishin krijuar për të vepruar si streha kundër erës për të ndihmuar krijimin e një mikroklimë bujqësore të favorshme.



Vajzë shkolle nga Sahara. Foto e lurdesim/www.flickr.com

Strehët kundër erës luftonin erozionin e lidhur me erën dhe tharjen e të korrave (prodhimeve).

Ato prodhonin gjithashtu lëndë drusore për gatim, pakësimin e ngarkesës së vajzave dhe grave për të mbledhur dru. Përdorimi i strehëve kundër erës çonte gjithashtu në prodhimin e shtuar të frutave dhe perimeve për shitje në treg.

⁵ Stern, N., 2006. *Analiza e Stern mbi Ekonominë dhe Ndryshimet Klimaterike*

⁶ Verësimi i Mijëvjeçarit për Ekosistemet. *Sinteza e Biodiversitetit*. 2005

⁷ Seck, M., Mamouda, M.N.A. and S. Wade, 2005. *Vulnerabiliteti, përshtatja dhe katastrofat klimaterike: Rast Studimor 4: Përshtatja dhe Lehtësimi përmes "mjediseve prodhuese": rasti i rritjes së bujqësisë në Senegal. Instituti i*

Studimeve për Zhvillim. Buletini IDS, Vol. 36, Nr. 4.

Biodiversiteti, ndryshimet klimaterike dhe Synimet e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (MDGs)



BIODIVERSITETI DHE NDRYSHIMET KLIMATERIKE: LIDHJET ME SHËNDETIN

Ndryshimi klimaterik po kërcënon biodiversitetin, duke rrezikuar realizimin e Synimeve të Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Mijëvjeçarit (MDGs). Mbrojtja e Biodiversitetit dhe mbrojtja e integritetit të ekosistemeve janë thelbësore në uljen e cënueshmërisë së njerëzve ndaj ndryshimit klimaterik dhe ndaj realizimit të MDG-s.

MDG 4: REDUKTIMI I VDEKSHMËRISË TEK FËMIJËT

Qëllimi i katërt i MDG synon të reduktojë me dy të tretat nivelin e vdekshmërisë midis fëmijëve nën moshën pesë vjeç deri në vitin 2015.

MDG 5: PËRMIRËSIMI I SHËNDETIT TË NËNËS

Qëllimi i pestë i MDG synon të reduktojë me tre të katërtat, raportin e vdekshmërisë së nënës (amënore) deri në vitin 2015.

MDG 6: LUFTIMI I HIV/AIDS, MALARJES DHE SËMUNDJEVE TË TJERA

Objektivi i parë i qëllimit të gjashtë të MDG është të ndalojë dhe të fillojë të zbrapsë shpërndarjen e HIV/AIDS deri në vitin 2015. Objektivi i dytë është të ndalojë dhe të ndërrojë vendet incidencës së malarjes dhe sëmundjeve të tjera madhore deri në vitin 2015.

Roli i biodiversitetit në arritjen e qëllimeve që lidhen me shëndetin

Shëndeti njerëzor varet ndjeshëm nga mjedisi shëndetësor dhe mbrojtja e funksionimit të ekosistemeve. Kjo është nënvizuar gjatë raporteve të fundit të Organizatës Botërore të Shëndetit (OBSH) dhe Vlerësimit të Mijëvjeçarit mbi Ekosistemet¹ që gjithashtu zbulon se burimet e biodiversitetit sigurojnë ushqimin e nevojshëm për të luftuar kequshqyerjen dhe mosushqyerjen, një shkak i rëndësishëm në vdekshmërinë foshnjore. Shërbime të tjera të ekosistemeve të siguruar nga biodiversiteti përkrahin shëndetin duke filtruar substancat helmuese nga ajri, uji dhe tokat bujqësore dhe duke ndaluar hedhjen dhe riciklimin e lëndëve ushqyese.

Përveç rritjes së shërbimeve të ekosistemeve, biodiversiteti siguron gjithashtu një burim unik dhe të pazëvendësueshëm për barnat. Organizata Botërore e Shëndetit² vlerëson që deri në 80% e popullsisë të Afrikës përdorin barnat tradicionale për kujdesin primar shëndetësor³. Deri në një shtirje shumë të gjerë ky bar është nxjerrë drejtpërdrejt nga bimët endemike. Bimët, kafshët dhe mikrobet kanë gjithashtu një vlerë të pafund në mjekësinë moderne. Substancat e nxjerra



Foshnjë në krahët e nënës duke marrë vaksinën e poliomielitit. Foto e UNEP

prej tyre janë përdorur si barna për trajtimin e shumë sëmundjeve. Këto barna përfshijnë për shembull kininën, barin për trajtimin e kancerit Taxol dhe antibiotikë të tillë si tetraciklinat dhe eritromicina⁴. Shumë prej këtyre substancave janë në pritje për t'u zbuluar.

1 Vlerësimi i Mijëvjeçarit për Ekosistemet. Sintezë e Biodiversitetit. 2005
2 Chivian, E., 2002. Biodiversiteti: Eshhtë shumë i rëndësishëm për shëndetin njerëzor. Një Projekt i Qendrës për Shëndetin dhe Mjedisin në Botë. Shkolla Mjekësore e Harvardit.
3 WHO, 2000. Mjekësia tradicionale. Analiza nr. 1_4.
4 Roe, D., 2004. Qëllimet e Zhvillimit të Mijëvjeçarit dhe Mbrojtja-Menaxhimi i Shëndetit të Natyrës për Shëndetin e Shoqërisë.. ILED.

Ndikimet e ndryshimit klimaterik në arritjen e MDGve 4, 5 dhe 6

Ndryshimi klimaterik, përmes ndryshimeve gjeografike në strukturën e motit, reshjet dhe temperatura, parashi-



Mushkonjë në procesin e ushqimit. Foto e Reino Meriläinen

nga personi tek personi të tilla si kolera, dizanteria dhe çojnë në rritjen e vdekshmërisë në lidhje me vapën dhe sëmundjet.

Përmbytjet dhe thatësitat mund të çojnë në keqësimin e sasisë dhe cilësisë së ujit të pijshëm, i cili është një kusht i domosdoshëm për një shëndet të mirë dhe parandalimin e vdekshmërisë foshnjore. Ndryshimi klimaterik mund të rëndojë keqshqyerjen duke kufizuar prodhimin e burimeve natyrale.

Prevalenca e shtuar e sëmundjeve të lidhura me klimën do të shtojë tensione të reja në sistemet shëndetësore të tronditura tashmë nga HIV/AIDS. Njerëzit në vendet në zhvillim dhe më pak të zhvilluara që jetojnë me HIV/AIDS janë veçanërisht të prekshëm pasi ata janë më të prekshëm nga sasitë e pakta ushqimore dhe infeksionet⁵. Kjo prekshmëri është ndikuar nga transmetimi i HIV/AIDS i vëzhguar kohët e fundit nga zonat urbane në zonat rurale. Vlerësimi tregon se 80 % e njerëzve që jetojnë në vendet më të prekura nga HIV/AIDS mbështeten në mjetet e jeteësës të bazuara tek bujqësia, të cilat janë të mundshme të kërcënohen nga ndryshimi klimaterik⁶.

Biodiversiteti dhe faktorët e ndryshimit klimaterik për realizimin e MDG 2 dhe 3

Një hap kyç në harmonizimin e biodiversitetit dhe faktorëve të ndryshimit klimaterik në MDGtë që



Periwinkle is touted as a miracle plant in the medicinal world as it contains chemical properties used to treat diabetes and cancer. It is a native of Madagascar but is now widely cultivated around the world. Photo courtesy of adamgaston/www.flickr.com



Pyjet tropikale janë një buim kryesor i mjekësisë që e ka origjinën nga diversiteti i tyre biologjik. Foto e Derek J. Bell

lidhen me shëndetin është zhvillimi i një të kuptuari të përmirësuar mbi ndikimet e pritshme dhe strategjitë e mundshme të përshtatjes. Të kuptuarit e ndikimeve të ndryshimit klimaterik mbi bimët mjekësore dhe bartësve të sëmundjeve është e domosdoshme për planifikimin e shëndetit nën ndryshimin e kushteve klimaterike.

Përmirësimi i shëndetit dhe higjenës kërkon ekosisteme të shëndetshme, që funksionojnë për të pajisur me ujë të pastër, burime gjentike për barnat dhe burime natyrore për të plotësuar nevojat ushqimore. Aktivitetet që synojnë të përshtatin ndryshimin klimaterik duke siguruar një mjedis të shëndetshëm dhe të sigurt mund t'i japin shtysë shëndetit të njerëzve.


Një projekt që u mbajt në thatësitë e shtrirë në krahinën Tonk në Rajasthan, Indi⁷, jep shembuj të aktiviteteve të përshtatjes së ndryshimit klimaterik që mund të përfitojnë të dyja sistemet: biodiversiteti dhe shëndeti. Praktikat e ndërmarra të përshtatjes u mbështetën mbi njohuritë e mëparshme mbi aftësinë për të administruar ujin, bujqësinë dhe mjetet e jetesës. Aktivitetet përfshinë: rritjen e prodhimeve të tillan si perimet, foragjerët dhe bimët mjekësore; ruajtja e përmirësuar e ujit dhe teknikat e korreve; dhe përdorimi i polenizuesve në gjendje të mirë mjedisore. Aktivitete të tilla të lidhura me biodiversitetin përmirësojnë kapacitetin për të përballuar ndryshimin klimaterik ndërsa garantohet siguri i ushqimit dhe kufizohen kërcënimet mbi shëndetin.

⁵ FAO. Mbrojtja nga HIV/AIDS dhe Ushqimore. Direkt në Internet në adresën <http://www.fao.org/hiv/aids/>

⁶ FAO. Mbrojtja nga HIV/AIDS dhe Ushqimore. Direkt në Internet në adresën <http://www.fao.org/hiv/aids/>

⁷ Chatterjee, K., 2005. Vulnerabiliteti, përshtatja dhe katastrofat klimatike: Rast studimi 2: Përshtatja e komunitetit ndaj thatësisë në Institutin e Rajasthanit të Shtimeve mbi Zhvillimin. Buletini IDS, Vol. _6, Nr. 4.

Biodiversiteti, ndryshimet klimaterike dhe Synimet e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (MDGs)



BIODIVERSITETI DHE NDRYSHIMET KLIMATERIKE: LIDHJET ME QËNDRUESHMËRINË MJEDISORE

Ndryshimi klimaterik po kërcënon biodiversitetin, duke rrezikuar realizimin e Synimeve të Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Mijëvjeçarit (MDGs). Mbrojtja e Biodiversitetit dhe mbrojtja e integritetit të ekosistemeve janë thelbësore në uljen e prekshmërisë së njerëzve nga ndryshimet e klimës dhe ndaj arritjes së MDG-s.

MDG 7: GARANTIMI I MBËSHTETJES MJEDISORE

Objektivat për qëllimin e shtatë të MDG janë të: i) harmonizojë parimet e zhvillimit të mbështetjes në politikat dhe programet e vendeve dhe të ndryshojë humbjen e burimeve mjedisore; ii) të përgjysmojë, deri në vitin 2015, raportin e njerëzve që nuk kanë mundësi të kenë ujë të pijshëm të sigurt; iii) arritja, deri në vitin 2015, e një përmirësimi domethënës në jetët e të paktën 100 milion banorëve të lagjeve të varfra.

Roli i biodiversitetit në arritjen e qëllimeve që lidhen me shëndetin

Biodiversitetin luan një rol të rëndësishëm në funksionimin e ekosistemeve që sigurojnë mbështetje, rezerva ushqimore, rregulla dhe shërbime kulturore thelbësore për qëniet njerëzore. Për shembull, njerëzit mbështeten tek biodiversiteti për ushqime, barna, lëndë e para dhe shërbimet e ekosistemeve të tilla si furnizimi me ujë, ciklimi ushqimor, trajtimi i mbetjeve dhe pllenimi.

Gjatë shekullit të fundit shumë njerëz kanë përfituar nga shkëmbimi i ekosistemeve natyrore në ekosisteme të dominuara nga dora e njeriut dhe përdorimi i biodiversitetit. Sidoqoftë, këto ndryshime kanë shkaktuar sëmundje të rënda në qëniet njerëzore. Sipas Vlerësimit të Mijëvjeçarit mbi Ekosistemet¹,



Gra tek pusët e ujit, Jaisalmer, India. Foto e Jason Shields

humbja e biodiversitetit dhe përdorimi i shërbimeve të ekosistemeve kontribuojnë –drejtpërdrejt ose në mënyrë jo të drejtpërdrejtë– në keqësimin e shëndetit, pasiguri më të lartë mbi ushqimin, rritje të prekshmërisë, një ulje në të mirat materiale dhe keqësim të marrëdhënieve shoqërore, duke përfshirë më pak liri të zgjedhjes dhe të veprimit.

Ndikimet e ndryshimit klimaterik në mbështetjen mjedisore

Ndryshimi klimaterik pritet të ketë ndikime domethënëse në aftësinë tonë për arritjen e MDG7.



Gra të zonave rurale të Etiopise duke ngritur barrat me dru. Foto te Studios DC/www.flickr.com



Gra në Tailandë duke punuar për ripyllëzim. Foto e UNDP/GEF Programi i Granteve të Vogla

Efektet e ndryshimit klimaterik mund të shndërrojnë cilësinë dhe prodhimin e burimeve dhe ekosistemeve. Këto ndryshime mund të reduktojnë biodiversitetin dhe komplekset ekzistuese të degradimit mjedisor.

Ndryshimet në strukturën e reshjeve, periudhat më të gjata të thatësirës dhe futja e ujrave të kripura në rezervat e ujrave të ëmbla duket që po rritin sasinë e pakta të ujrave të pijshëm.

Rritja e niveleve të detit mund të shkaktojë humbjen e tokave të lërueshme (punueshme) në zonat bregdetare dhe mund të ndikojë ashpër tek njerëzit që jetojnë në zona me përmytje, duke çuar në largimin e banorëve nga këto zona. Për shembull, vendbanimi i Lateu, i vendosur në zinxhirin e Vanuata të ishujve të Paqësorit, ishte rivendosur kohët e fundit për t'i shpëtuar ngritjes së nivelit të deteve².

Ndryshimi klimaterik do të ketë gjithashtu një ndikim mbi burimet e biodiversitetit që garantojnë funksionet e mbështetjes së ekosistemeve. Në fakt, ndryshimi i klimës pothuajse po i detyron speciet të përshtaten edhe përmes ndryshimit të vendbanimit, ndryshimit të cikleve të jetesës ose zhvillimit të veçorive të reja fizike. Speciet që nuk mund të përshtaten përballen me zhdukjen.

Biodiversiteti dhe faktorët e ndryshimit klimaterik për arritjen e MDG 7

Është e qartë që klima në gjithë botën po ndryshon dhe është një lloj e qartë që burimet e biodiversitetit po humbasin. Humbja e biodiversitetit ka një ndikim

negative mbi mbështetjen e shërbimeve mjedisore. Këto përpjekje frenuese për arritjen –jo vetëm të MDG 7- të gjithë Synimeve të Zhvillimit të Mijëvjeçarit. Nga ana tjetër, mbrojtja e biodiversitetit dhe përdorimi i mbështetjes mund të rritë në mënyrë domethënëse përpjekjet për të arritur MDG 7. kjo, sidoqoftë, nuk mund të përmbushet pa marrë në konsideratë ndikimet e ndryshimit klimaterik mbi biodiversitetin dhe shërbimet e lidhura me ekosistemin.

Marrja në konsideratë e çështjeve të ndryshimit klimaterik kur hartohen aktivitetet e reagimit është thelbësore për garantimin e mbështetjes mjedisore. Aktivitetet për mbrojtjen e biodiversitetit që adresojnë ndikimet e zbutjes së ndryshimit të klimës dhe përshtatjes ndihmojnë gjithashtu në arritjen e MDG 7. Për shembull, nga viti 1992 deri në vitin 2000, një grup prej 17 fshatrash në thatësirën e prirur në Provincën Bara në Sudanin Perëndimor morën pjesë në një projekt për rehabilitimin e tokave malore të tejshfrytëzuara dhe shumë të dobëta përmes përdorimit të teknikave të administrimit të burimeve natyrore me bazë komunitare³. Objektivat e projektit ishin të krijohej një sistem lokal i mbështetjes së burimeve natyrore që do të parandalonte njëkohësisht



Tregu lundrues në Ishullin e Sitangkai, Tawi-tawi, Filipine. Foto e Farley Baricuatro

tejshfrytëzimin e tokave të varfra dhe rehabilitimin e tokave malore për qëllimin e izolimit të karbonit, mbrojtjes së biodiversitetit dhe reduktimit të pluhurit atmosferik. Si rezultat, u përmirësuan dhe u administruan më së miri 700 hektarë të tokave malore. Me administrimin e përmirësuar të tokës dhe një bazë më të sigurt të asetëve mjedisore dhe sociale, komunitetet ishin në gjendje të rritnin aftësinë ripërtëritëse ndaj ndikimeve të ndryshimit klimaterik.

² Krijimi i Kapaciteteve për Zhvillimin e Masave të Përshtatjes në Pacifik & Shtetet e Islandës c Programi rajonal Mjedisor (SPREP). Direkt në Internet në adresën <http://www.sprep.org/>

³ Projekt i mbështetur nga GEF. Rehabilitimi me Bazë Komunitar i Tokave të Amplitudave për izolimin e Karbonit. Direkt në internet në adresën <http://www.thegef.org/>

Biodiversiteti, ndryshimet klimaterike dhe Synimet e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (MDGs)



BIODIVERSITETI DHE NDRYSHIMET KLIMATERIKE: NJË PARTNERSHIP GLOBAL PËR ZHVILLIMIN

Ndryshimi klimaterik po kërcënon biodiversitetin, duke rrezikuar realizimin e Synimeve të Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Mijëvjeçarit (MDGs). Mbrojtja e Biodiversitetit dhe mbrojtja e integritetit të ekosistemeve janë thelbësore në uljen e prekshmërisë së njerëzve nga ndryshimet klimaterike dhe ndaj arritjes së MDG-s.

MDG 8: ZHVILLIMI I NJË PARTNERITETI GLOBAL PËR ZHVILLIM

Synimi i tetë i Zhvillimit të Mijëvjeçarit është kyçi për arritjen e të gjithë synimeve të tjera të MDGve, pasi ai bën thirrje për stabilizimin e një partneriteti global për zhvillimin. Në këtë këndvështrim, MDG 8 bën thirrje në mënyrë specifike për tregje të hapura bazuar në rregulla dhe sisteme financiare, vëmendje të veçantë ndaj nevojave të vendeve më pak të zhvilluara dhe të mbyllura, dhe Zhvillimi i shteteve të ishujve të vegjël, garantimi i mbështetjes, shtrirja e mundësive për punësimin e të rinjve dhe mundësitë e duhura për mbështetje shëndetësore dhe teknologji të reja.

Biodiversiteti dhe partneriteti global për zhvillimin

Biodiversiteti ka njëkohësisht vlerë lokale dhe globale. Në nivelin lokal, biodiversiteti është i nevojshëm për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjeteve të jetesës të bazuara mbi biodiversitetin. Në nivelin global, biodiversiteti kontribuon në rregullimin e shërbimeve të ekosistemeve, të tilla si ciklimi¹ i ujit dhe ushqimeve, dhe zhvillimin e produkteve të tilla si ushqimi dhe barnat.

Administrimi i biodiversitetit varet nga veprimet e marra



Gratë e Maasait brenda zonës së konservimit të komunitetit. Foto e Franz Dejon



Il Zonat e Ngwesit dhe Lewas janë shembuj të zhvillimit të mirë lokal nëpërmjet turizmit me bazë komunitare dhe jetesë alternative bazuar në përdorimin e qëndrueshëm të burimeve të biodiversitetit. Foto e Colby Lyons

në të gjitha nivelet: lokale, kombëtare, nën-rajonale dhe globale. Në nivelin lokal, veprimet për mbrojtjen e biodiversitetit adresojnë kërcënime të tilla si humbja e habitatit dhe tejkorrrjet. Këto veprime janë të lidhura shpesh me zhvillimin lokal përmes projekteve të tilla si turizmi me bazë komunitar dhe mjetet e ndryshueshme të jetesës me vlera të shtuara bazuar në korrrjet

e mbështetura në burimet e biodiversitetit. Një shembull i një projekti të tillë është Zona e Mbrojtjes së Komunitetit Il Ngwesi, komuniteti i parë që fitoi dhe administroi destinacionin e turistëve të stabilizuar në Kenia². Projekti Il Ngwesi synonte më në mënyrë specifike të rritë mundësitë ekonomike lokale ndërsa garantonte mbrojtjen e biodiversitetit të rëndësishëm.

